

Bordi Drejtues i ODËS SË INXHINIERËVE NË FUSHËN E NDËRTIMIT me nr. Fiskal 603383324, në mbështetje të nenit 17, paragrafi 5, nën paragrafi 5.14 të LIGJIT NR. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, dhe në mbështetje të nenit 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.21 të STATUTIT TË ODËS SË INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PERIUdhËN E PËRKOHSHME, i miratuar më datën 31.12.2024, me nr. Të protokollit 8648/24, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 01.04.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

1. Që Komisioni i Ankesave të Odës, i zgjedhur nga Kuvendi, **autorizohet ad hoc** për të trajtuar dhe vendosur mbi të gjitha ankesat që mund të paraqiten në lidhje me procedurat e rekrutimit të Drejtorit Ekzekutiv dhe Zyrtarëve të Administratës, sipas konkursit të shpallur nga OIRK.
2. Komisioni do të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore dhe statutare në fuqi, duke siguruar trajtim të paanshëm dhe të drejtë të secilës ankesë. **Komisioni obligohet që të shqyrtojë dhe të vendosë për të gjitha ankesat e pranuar, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike nga data e përfundimit të afatit për paraqitjen e ankesave.**
3. Ky autorizim është i **përkohshëm dhe i kufizuar vetëm për rastin në fjalë, dhe nuk cenon kompetencat tjera të organeve të Odës të përcaktuara me Ligj dhe Statut.**
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit Mbikqyrës.
- Anëtarëve Themelues të Odës.
- Arkivit të OIRK-së.

Bordi Drejtues i OIRK-së:

1. **Arsim Rapuca**
Kryetar i OIRK-së 
2. **Mimoza Shahini**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së 
3. **Kadri Morina**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 
4. **Afrim Demiri**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 
5. **Nebi Pllana**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 
6. **Bujar Jupaj**
Anëtare e Bordit Drejtues të OIRK-së 
7. **Sami Kolgeci**
Anëtarë i Bordit Drejtues të OIRK-së 